

qëlluar me pushkë snajperi. Ka ndërruar jetë në rrugë për në spitalin e Prishtinës/Priština. Familjarët e kanë varrosur më 17.10.1998 në varrezat e Ribarit.

Burimet: deklarata D.S, FDH-32257; SMIP, *Teroristički...*, III, 546, 941; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 65; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Fehmi (Brahim) Kastrati

(15.07.1978, shqiptar nga Kizhnareka/Kišna Reka, komuna e Gillogocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Fehmiu u bë pjesëtar i UÇK-së më 12.04.1998. Ka rënë në betejë me forcat serbe te vendi i quajtur *Rreza e Lladrocit/Ladrovački zrak [Lladroc/Ladrovac]*, e cila u zhvillua më **16.10.1998**. Fehmiun e kanë varrosur me nderime ushtarake në një pyll në Kërzharekë/Kišna reka. Pas luftime, më 27.07.2001, mbetjet mortore të Fehmiut u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Kleçkë/Klečka [Lipjan/Lipljan].

Burimet: deklarata V.K, FDH-33470; SHFUDUÇK, *Feniksët...4*, 113-116; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-21014.

Shyqëri (Shaban) Krasniqi

(28.08.1970, shqiptar nga Lladroviqi/Ladrović, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, tre fëmijë)

Shyqëriu ka marr pjesë në sigurimin e fshatit të vet [Lladroviq/Ladrović], gjatë muajit tetor të vitit 1998. Forcat serbe ishin të stacionuara në fshatin fqinj të Kleçkës/Klečka [Lipjan/Lipljan]. Në mëngjes, më **22.10.1998**, rreth orës 4:30, Shyqëriu ishte duke e mbajtur rojën te shkolla fillore me mikun e vet Hashimin. Kur dëgjuan të shtënat nga fshati fqinj të Guncatit/Guncat, Hashimi doli për të observuar situatën dhe, më pas, u kthye duke thënë se nuk kishte asgjë. Pastaj Shyqëriu shkoi për ta vëzhguar situatën. Pas pak, Hashimi dëgjoi të shtënat. Nisi ta thërriste Shyqëriun, por nuk kishte kurrfarë përgjigje. Nuk kaloi shumë dhe te shkolla erdhën pjesëtarët e UÇK-së. Edhe ata nisën të kërkonin Shyqëriun. Pas disa minutash, e gjetën trupin e tij të pajetë në oborrin e shkollës. Në kokë e kishte një plagë nga plumbi. E çuan trupin e Shyqëriut te shtëpia e tij.

Ditën e nesërme, familjarët e kanë varrosur atë në varrezat e *Lagjes së Poshtme/Donje Naselje* në Lladroviq/Ladrović.

Burimet: deklarata H.B, FDH-17230; fotografi, FDH-18858.

Ali (Murat) Paçarizi

(24.08.1979, shqiptar nga Dragobili/Dragobilje, komuna e Malishevës/Mališevo, tregtar, pjesëtar i UÇK-së)

Para luftës, Aliu merrej me tregti. Në muajin maj të vitit 1998, ai aderoi në UÇK. Familjarët e Aliut e kanë braktisur shtëpinë e vet më 25.09.1998, kur forcat serbe e sulmuan fshatin [Dragobil/Dragobilje]. Banorët u kthyen pas nënshkrimit të marrëveshjes *Holbrooke – Milošević* më **27.10.1998**. Aliu shkoi te familja e vet në Pagarushë/Pagaruša, ku ishin strehuar përkohësisht, dhe i ftoi që të ktheheshin. Ai u nis në shtëpi para familjes së vet. Me bashkëluftëtarët Hakiun dhe Arsimin u nisën për ta vëzhguar situatën në fshat. Përderisa po kalonin pranë shitores së Aziz Paçarizit, kanë rënë mbi një minë tokësore. Eksplodimi i saj Aliut ia mori jetën në vend, ndërkaq Hakiu dhe Arsimi u plagosën rëndë. Po atë ditë, Aliun e varrosën në varrezat e fshatit fqinj të Maralisë/Maralija. Pas luftime, më 8.05.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Aliut në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Malishevë/Mališevo.

Burimet: deklarata M.P, FDH-33016; deklarata K.P, FDH-2083,IS; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 153, FDH-23857; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; *One Albanian Dies, Two Wounded, from Explosion of Mine near Malisheva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 28.10.1998, FDH-29781.

Ilja (Vasilje) Vujošević

(2.08.1950, serb nga Prishtina/Priština, katër fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dejan (Žarko) Djatlov

(3.02.1975, serb nga Fushë Kosova/Kosovo Polje, elektroteknik, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Ilja punonte në SPB-në e Prishtinës/